



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Integrimin Europian***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 3.2.2021, ora 12:00

**Drejton mbledhjen:**

**Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të datës 26.01.2021.
2. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015 “Për eficiencën e energjisë”, i ndryshuar””.
3. Të tjera

**Marrin pjesë:**

Senida Mesi, Klodiana Spahiu, Nikolin Staka, , Kostaq Papa, , Arlind Çaçani, Edlira Hyseni, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Artemis Dralo, Ilir Pendavinji, Vasil Sterjovski, Ralf Gjoni, Fatmir Velaj dhe Musa Ulqini,

**Mungojnë:**

Rudina Hajdari , Sadri Abazi, Taulant Balla,

**Të ftuar:**

Gjergj Simaku- Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Laureta Dibra - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Rudina Xhelilaj – Drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

## HAPET MBLEDHJA

**Senida Mesi** – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar kolegë deputetë dhe të ftuar, fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Integrimin Europian.

Sikurse e keni marrë dhe agjendën, sot do të diskutojmë projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.124/2015 “Për eficiencën e energjisë”, i ndryshuar””.

Në postën tuaj elektronike keni marrë dhe procesverbalin e datës 26 janar 2021, i cili është për t’u miratuar ditën e sotme, si dhe çështje të tjera, sipas kërkesave apo diskutimeve në vijim.

Nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës kemi të ftuar zotin Gjergj Simaku, zëvendësministër.

Përshëndetje, zoti Simaku!

**Gjergj Simaku** – Përshëndetje!

**Senida Mesi** - Kemi të ftuar zonjën Laureta Dibra, përgjegjëse sektori, dhe zonjën Rudina Xhelilaj, drejtoreshë drejtorie.

Pa humbur kohë, do të doja të kaloja në miratimin e procesverbalit të datës 26 janar 2021. Kush është dakord?

Miratohet.

Për sa i përket projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.124/2015 “Për eficiencën e energjisë”, i ndryshuar”, pa humbur kohë do të doja t’ua kaloja fjalën përfaqësuesve të ministrisë, konkretisht, zotit Simaku, dhe më pas zonjës Dibra ose zonjës Xhelilaj, nëse kanë diçka për të shtuar. Më pas do të vijojmë me diskutime dhe pyetje nga kolegët deputetë.

Zoti Simaku, fjala është për ju.

**Gjergj Simaku** – Faleminderit!

Ju përshëndes të gjithëve!

Do të mundohem të jem sa më konciz në prezantimin e këtij projektligji.

Në fakt, projektligji që vjen në Kuvend është e dyta herë që rishikohet. Hera e parë ka qenë në vitin 2015, si një kërkesë e domosdoshme për transpozimin e direktivës së vitit 2021, më pas u bë një ndryshim në vitin 2019 për certifikimin e audituesve të energjisë dhe tashmë ka ardhur për transpozimin e plotë, sipas kërkesave të Komunitetit të Energjisë, ku Shqipëria është palë kontraktuese.

Në këtë kuptim, ne sjellim disa risi në këtë ligj, por bëjmë edhe një, si të thuash, rezyme të shkurtër lidhur me impaktin që pati ligji gjatë këtyre viteve. Duhet të them se gjatë këtyre viteve ligji nuk ka pasur ndonjë efekt të jashtëzakonshëm, megjithatë, si ligj që krijon institucionet e eficiencës së energjisë dhe që u prezantua herën e parë pas direktivës, me ndihmën e Komunitetit të Energjisë, tani ka filluar të japë rezultate. Ne e kemi të vendosur tashmë të gjithë bazën nënligjore të ligjit aktual, institucionet kanë filluar punën e tyre, Agjencia për Eficiencën e Energjisë është e tëra në punë dhe po bën një punë të shkëlqyer për certifikimin e auditëve dhe fillimin e obligimeve, që kanë të bëjnë me objektivin kombëtar për vitin 2020, i cili praktikisht, nëpërmjet një plani kombëtar, vendosi të shikojë objektiva për këtë ligj.

Gjithashtu, duhet të them se shtesat në projektligjin e ri kanë të bëjnë me forcimin e mëtejshëm të proceseve integruese, pra ka qenë një kërkesë e konsoliduar e Komunitetit të Energjisë në Vjenë, ku Shqipëria është palë kontraktuese dhe ka të bëjë me këto 4-5 çështje kryesore, të cilat janë: krijimi i një kornize ligjore, që mundëson realizimin e objektivave të kursimit të energjisë përmes planit kombëtar për eficiencën e energjisë dhe çdo plani tjetër që vjen për klimën dhe energjinë; mënjanon më tej barrierat rregullatore dhe jorregullatore, që pengojnë zbatimin e masave të eficiencës; krijon një marrëdhënie të shëndoshë me konsumatorin, prodhuesit dhe furnizuesit e energjisë, duke u vendosur atyre skema detyruese për kursimin e energjisë; promovon më tej teknologjitë efikase dhe menaxhimin e energjisë; përdor mekanizma financiarë dhe stimuj për të zbatuar masat për eficiencën dhe, gjithashtu, zhvillon më tej tregun e shërbimeve të energjisë dhe ofruesve të shërbimeve të energjisë.

Në këtë kuptim, ky projektakt vjen si një rekomandim i rëndësishëm i të gjitha raporteve të kohëve të fundit nga Komisioni Europian, sidomos atij që ka ardhur për vitin 2020. Ka qenë një kërkesë e vazhdueshme që direktiva nr. 27, datë 25 tetor 2012, e parlamentit dhe Këshillit Europian, të transpozohet plotësisht në kushtet e Shqipërisë. Duhet thënë në këtë mes që, edhe sipas opinioneve të shërbimeve të komisionit, në Kuvendin e Shqipërisë kërkohet një diskutim për atë çka kemi bërë ne për direktivën e re, pra për direktivën 2018, që është rishikuar dhe ka shfuqizuar disa akte të direktivës së vitit 2012.

Duhet të sqaroj në këtë mes që vetë Komuniteti i Energjisë, nga i cili ne japim llogari për *acquis communautaire*, akoma nuk e ka dhënë opinionin e vet për këtë çështje, pasi pritet të mbledhet Këshilli i Ministrave të vendeve të Ballkanit Perëndimor ose i palëve kontraktuese, që do të marrë një vendim për të adresuar direktivën e re të vitit 2018 “Për eficiencën e energjisë”. Gjithsesi, ajo që kemi marrë ne në konsideratë në ndryshimet e këtij projektligji është se parashikohet nga ligji që të thellohet më tej mirëqeverisja e institucioneve të eficiencës

së energjisë dhe vendosja në stabilitet të plotë e ekspertëve të pavarur, që janë audituesit e energjisë dhe ekspertët e varur nga konsumatori, që janë menaxherët e energjisë, të cilët së bashku do të krijojnë pas auditit një raport për kursimet e energjisë në çdo konsumator të madh.

Ndryshimet ligjore përgjithësisht kanë të bëjnë me skemën e mbështetjes, kanë të bëjnë me skemën detyruese për këta lloj konsumatorësh të mëdhenj, gjithashtu, kanë të bëjnë dhe me identifikimin e konsumatorëve të mëdhenj dhe detyrimin e tyre për t'u audituar nga pikëpamja energjetike.

Unë mund të them dhe plot gjëra të tjera, por kur të shkojmë te diskutimi nen për nen jemi të gatshëm të diskutojmë.

Ju faleminderit!

**Senida Mesi** – Ju faleminderit, zoti Simaku!

Kemi të pranishëm këtu dhe përfaqësuesin e Drejtorisë së Përfarimit të Legjislacionit, zotin Kasneci, të cilit do të dëshiroja t'ia kaloja fjalën dhe për të diskutuar çështje, të cilat ju, të nderuar kolegë, i keni marrë tashmë në postën tuaj elektronike, pra se ku janë dakordësuar ato dhe ku nuk kemi dakordësi me pjesën e ekzekutivit, me Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës.

Zoti Kasneci, fjala është për ju.

**Dedë Kasneci** – Faleminderit, zonja zëvendëskryetare!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti zëvendësministër,

Siç u prezantua dhe nga zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, zoti Simaku, projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin e vitit 2015 “Për eficientësinë e energjisë” ka për qëllim kryesor të përafrojë më tej legjislacionin shqiptar në këtë fushë me legjislacionin e Bashkimit Europian. Siç u tha, konkretisht, është përafruar pjesërisht me direktivën nr.27 të Bashkimit Europian, të vitit 2012, “Për eficientësinë e energjisë”, e ndryshuar”. Pra, në projektligj janë përfshirë disa elemente të kësaj direktive, të cilat në ligjin e vitit 2015 nuk ishin përfshirë.

Siç e tha edhe zoti zëvendësministër, në fakt, kjo direktivë është ndryshuar ndër vite, është ndryshuar 6 herë, ku sidomos ndryshimi i vitit 2018 është shumë thelbësor.

Për sa i përket argumentimit, që u tha se do të presim çfarë do të thotë Komuniteti i Energjisë, në fakt, Shqipëria ka një bazë ligjore dhe më të fortë dhe më detyruese se Komuniteti i Energjisë. Neni 70 i MSA-së parashikon se Shqipëria ka detyrim të përafrojë legjislacionin aktual dhe të ardhshëm me legjislacionin e Bashkimit Europian, ku përfshihet edhe fusha përkatëse. Pavarësisht kësaj, në relacion është thënë dhe nuk paraqet ndonjë problem, pra ajo do të bëhet në faza të mëvonshme, por thjesht duhet të jetë e qartë për ministrinë që neni 70 i

MSA-së, pavarësisht se çfarë thotë Komuniteti i Energjisë, i detyron të vazhdojnë me përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit.

Direktiva që është përafuar synon përmirësimin e eficiencës së energjisë me 20% deri në vitin 2020, krahasuar me nivelet e vitit 1990, dhe parashikon që të gjitha shtetet anëtare të BE-së të fiksojnë objektiva kombëtare, me qëllim arritjen e këtij objekti.

Direktiva promovon eficiencën e energjisë në BE përmes një kuadri të përbashkët normash, që mbulon të gjitha fazat e zinxhirit të energjisë, nga prodhimi te shpërndarja e te konsumatori final.

Shërbimi ynë, në mbështetje të veprimtarisë suaj ligjvënëse, e nderuar zonja zëvendëskryetare, të nderuar deputetë, ka analizuar përputhshmërinë e neneve të projektligjit me nenet përkatëse të direktivës së BE-së dhe për një përafrim më korrekt, pavarësisht se përafrimi ka qenë i mirë, në linjë me parashikimet e direktivës, kemi paraqitur 6 sugjerime, ku për 5 prej tyre është gjetur dakordësia, ndërsa për një nuk është gjetur dakordësi.

Elementi për të cilin nuk është gjetur dakordësia është pika 4 e opinionit tonë. Duke iu referuar tekstit të projektligjit, neni 6 i projektligjit parashikon të shtohen disa nene, ku mes tyre është dhe neni 9/4: “Roli model i ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore”. Formulimi i pikës së parë të këtij neni në versionin që është propozuar nga qeveria është si vijon: “Duke filluar nga data 1.9.2021, sektori publik siguron se minimalisht 2% e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike të rinovohet çdo vit, me qëllim që të arrihen objektivat e performancës së energjisë”. Shërbimi ynë, nga krahasimi që i kemi bërë këtij formulimi me nenet përkatëse të direktivës, konstaton se direktiva e ka 3% dhe projektligji e ka 1% më pak se parashikimet e direktivës.

Në argumentimin që ka paraqitur ministria argumenti qëndron, në kuptimin ekonomik, sepse thuhet që për arsye buxhetore është parashikuar 2%, por ne i qëndrojmë sugjerimit tonë dhe sidomos, e nderuar zonja zëvendëskryetare, të nderuar deputetë, i nderuar zëvendësministër, nëse nisemi nga vetë titulli i neni thuhet: “Roli model i ndërtesave të organeve publike”. Pra, organet publike duhet të jenë model dhe duhet të jenë pararojë në ristrukturimin dhe në plotësimin e të gjitha kërkesave të eficiencës së energjisë. Duke pasur parasysh që është një kërkesë e direktivës, duke pasur parasysh që bëhet fjalë për ndërtesa publike, që duhet të jenë pararojë në çdo gjë dhe pastaj të ndiqet edhe nga të tjerat, ne i qëndrojmë sugjerimit tonë që të ndryshohet nga 2%, siç është në projektligj, në 3%.

Ju takon juve, të nderuar deputetë, të vendosni se cilin version do të miratoni.

Faleminderit për vëmendjen!

**Gjergj Simaku** - A mund të përgjigjem, zonja kryetare?

**Senida Mesi** - Një moment, zoti Simaku.

Në lidhje me të gjitha observacionet kuptojmë se jeni dakordësuar. Në fakt, edhe në mungesë të një relatori, pavarësisht se shpjegimi u dha nga përfaqësuesit e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, për mua është shumë e rëndësishme të përmendim disa elemente konkrete.

Shqipëria ka marrë disa përgjegjësi në lidhje me disa konventa ndërkombëtare, së pari.

Së dyti, sikurse e përmendi dhe zoti Kasneci, kemi të bëjmë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, të cilën e kemi për detyrë për ta realizuar dhe zbatuar, dhe në kuadër të procesit të integritimit kemi dhe konventat dhe autoritetet e tjera ndërkombëtare, ku duhet të shkojmë në linjë me çfarë kemi marrë përsipër, me çfarë jemi zotuar dhe me çfarë kemi firmosur në mënyrë vullnetare. Nuk mjafton vetëm procesi i integritimit në Bashkimin Europian, kemi parasysh edhe rezolutën në Kuvendin e Shqipërisë dhe aderimin e Shqipërisë në agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara për realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, konventën kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimin e klimës dhe, shumë e rëndësishme, marrëveshjen e Parisit të vitit 2015, ku shtetet anëtare të Bashkimit Europian, por dhe vende nga mbarë bota kanë, le të themi, përgjegjshmëri konkrete dhe reale, me objektiva reale, për të ulur pikërisht emetimin e dioksidit të karbonit në mjedis. Ne kemi një zotim, nëse nuk gaboj, që të shkojmë në uljen e dioksidit të karbonit në 11,5% deri në vitin 2030, krahasuar me skenarin bazë.

Këtu do të doja tashmë edhe nga përfaqësuesit e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, edhe nga përfaqësues të tjerë, që nuk janë sot të pranishëm (besoj se edhe kolegët e nderuar deputetë janë dakord) një raport të detajuar se çfarë ka bërë deri tani Agjencia e Eficiencës së Energjisë pikërisht për të realizuar këtë objektiv.

Për trajtimin apo elementet unë kam disa pyetje dhe sugjerime për ndryshim, të ardhura nga ekspertët dhe juristët e komisionit dhe të Kuvendit, ndërsa për çështjen 3% apo 2%, ju lutem, zoti Simaku, mund të komentoni!

Kolegë deputetë, bëhet fjalë për nenin 9/4 të projektligjit, ku thuhet: “Modeli i ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore”. Pika 1: “Duke filluar nga data 1.9.2021, sektori publik siguron se (faqja 6, për ata që e kanë përpara apo në kompjuter) minimalisht 2% e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike të rinovohet çdo vit për të përmbushur kërkesat minimale për performancën e energjisë”, ndërkohë që direktiva e Bashkimit Europian përcakton një nivel së paku 3%, pra 3% të sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave duhet të rinovohet. Këtu është, le të themi, mospërputhja ose mosdakordësimi.

Po ia kaloj fjalën zotit Simaku për shpjegimet në rastin konkret.

**Gjergj Simaku** - Faleminderit, kryetare!

Unë kërkoja të bëj një sqarim për këtë çështje. Faktikisht, për sa i përket direktivës, ajo ashtu shprehet, 3% e ndërtesave në pronësi, të zëna nga organet e qeverisjes qendrore, ndërsa në vendin tonë 2% është vendosur për të gjitha ndërtesat publike.

Dëshiroj dhe uroj që të bëjmë një diskutim shumë të pastër në këtë drejtim. Jam dakord me ju, por duhet të them diçka: në rast se në vendet e Bashkimit European kjo përqindje, pra 3%, është për ndërtesat e qeverisjes qendrore, në konceptin shqiptar ne, si ministri, e kemi shtrirë në të gjitha ndërtesat publike prona të shtetit, sepse këtu shfaqet edhe më tepër buxheti. Pra, nuk flasim vetëm për zyrat qendrore të qeverisë, por e kemi shtrirë definicionin e ndërtesave publike. Pra, konceptin e ndërtesave publike praktikisht ne e kemi rritur deri te konviktet, spitalet, shkollat, kopshtet, çerdhet, që të merren në konsideratë, sepse ato janë subjekte të financimit nga buxheti i shtetit.

Në një pikë më tutje ne kemi thënë që, dhe ju e keni bërë vërejtje me shumë kujdes dhe për këtë ju falënderoj, gjatë prokurimeve publike duhet të marrim në konsideratë kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave. Në këtë kuptim, bëhet fjalë që ne të adresojmë vetëm ato qendroret, pra vetëm ministrinë? Praktikisht ne, jo 2%...(Nuk dëgjohet)

**Senida Mesi** - Zoti Simaku, nuk jeni në linjë. Nëse më dëgjoni, po ju presim, në të kundërt, mund ta marrë fjalën zonja Dibra.

**Laureta Dibra** - Quhem Laureta Dibra. Në fakt, duke ndjekur zëvendësministrin, ne kemi diskutuar lidhur me shifrën 2 apo 3% dhe ideja ka qenë që, meqenëse ne jemi një vend i vogël dhe numri i ndërtesave publike në nivel qendror është relativisht i vogël, duke e krahasuar me vendet anëtare të BE-se, ne kemi përfshirë këtu edhe ndërtesat publike në nivel lokal, prandaj kemi vendosur edhe shifrën 2%, sepse, nëse do t'u referoheshim vetëm godinave të qeverisjes vendore, kjo është një sipërfaqe që mbyllet shumë shpejt në krahasim me impaktin që do të kishin të gjitha godinat publike edhe në nivel lokal.

**Senida Mesi** - Zoti Simaku, a jeni në linjë?

**Gjergj Simaku** - Po, por ndoshta isha *mute*.

**Senida Mesi** - Si rezultat i ndërprerjes së linjës me zotin Simaku e mori fjalën zonja Dibra, e cila na shpjegoi më shumë për shifrën 2 dhe 3%.

Zoti Simaku, mund të filloni me argumentimin tuaj.

**Gjergj Simaku** - Vërejtja është me vend, sepse kështu është në direktivë, por direktiva flet vetëm për ndërtesat publike në organet e qeverisjes qendrore. Praktikisht, në konceptin tonë duhet dhënë një definicion, të cilin mendoj ta propozojmë në ligj se cilat quhen ndërtesa publike. Në konceptin tonë, ndërtesa publike janë jo vetëm ato që janë në ngarkim të qeverisjes

qendrore, por edhe ato të qeverisjes lokale, si: kopshtet, shkollat, çerdhet, konviktet, spitalet, të cilat janë në pronësi të shtetit. Pra, këto janë përgjithësisht ndërtesa publike, por ndërtesa publike janë edhe supermarketet, vendet ku zhvillojmë mbledhje të ndryshme e kështu me radhë. Kështu që, unë dua të them se koncepti ynë për ndërtesa publike është i ndryshëm krahasuar me direktivën, e cila merr në konsideratë vetëm ato qendrore.

Unë solla një shembull, në ndërtesat qendrore ne kemi ndërhyrë në dy ndërtesa të mëdha, siç është ndërtesa e Kryeministrit, që të gjithë e kanë parë se sa mirë ka performuar ajo nga pikëpamja e eficiencës dhe izolimit termik, dhe ish-ndërtesa e transportit, e cila është bërë me kushtet e eficiencës së lartë të energjisë, që së shpejti do të marrë edhe klasën e energjisë se në cilin nivel konsumi është. Ky është modeli ekzemplar, ku të tjerët mund të marrin shembull. Pra, ne mendojmë që fillimisht ta lëmë 2%, por duke e shtrirë në të gjitha ndërtesat publike. Ky është definicioni për ndërtesat publike në përcaktimet e këtij ligji. Jam i gatshëm të ndikoj në këtë pjesë.

**Senida Mesi** - Zoti Simaku, a kemi një kostofikim se çfarë difference bëhet fjalë, që do të thotë 2 ose 3% ? Çfarë do të thotë nga ana e kostove, 3%-shi i godinave apo i stokut të godinave të qeverisjes qendrore kundrejt 2%-shit të sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike?

**Gjergj Simaku** - Po, keni të drejtë. Ne kemi bërë një llogaritje për këtë dhe kemi bërë një inventar të sipërfaqeve që zënë ndërtesat publike dhe ndërtesat jopublike, që janë ndërtesa rezidenciale, dhe kemi gjetur që rreth 15 milionë metër katrorë ndërtim ndërtesa publike, krahasuar me 60 milionë, që janë në total stoku i ndërtesave në të gjithë Shqipërinë. Pra, kemi bërë një kalkulim të kësaj natyre, të cilin e kemi gjetur dhe ka të bëjë me ndërtesat publike. Pra, në 15 milionë 2%, i bie jashtëzakonisht shumë. Mund të them se buxhetet, të cilat shkojnë për rinovim të ndërtesave duhet të marrin vlerën ligjore, që përcakton ligji “Për performancën e energjisë”, që gjatë rinovimit të tyre të ushtrohen masat e eficiencës së energjisë.

Ne kemi bërë edhe një nen lidhur me prokurimin, ku prokurimi publik detyrohet të flasë për ndërtesat publike, të ushtrohen masat për eficiencën e energjisë. Pra, të izolohet, të kursehet energjia, të bëhet auditimi i energjisë në të gjitha specifikat që çojnë drejt eficientimit maksimal të ndërtesave. Shembuj të kësaj natyre kemi, kemi Qytetin Studenti nr.2 me kostot që kanë ardhur grant nga Gjermania, si dhe kemi nisur projektin për Qytetin Studenti nr. 1, ku shumë ndërtesa do të shkojnë drejtë zeros, pra do ta vetëprodhojnë energjinë. Kështu që, ne jemi në rrugë të mbarë, por 2%-shi besoj se do ta rëndojë shumë buxhetin më vonë, nëse definicionin për ndërtesat publike e shtrijmë në të gjitha ndërtesat publike dhe jo vetëm në ato qendrore.



Ju faleminderit!

**Senida Mesi**- Faleminderit, zoti Simaku!

Zoti Kasneci ka një koment.

**Dedë Kasneci**- Në vijim të asaj që tha edhe zëvendësministri, është e vërtetë që direktiva kërkesë të detyrueshme ka vetëm godinat e administratës qendrore. Pra, këtë direktiva nuk e kërkon detyrimisht.

Unë sugjeroj, nëse pranohet nga zëvendësministri, që 3%-shi të lihet siç e ka direktiva dhe 2%-shi të lihet për organet e pushtetit vendor e kështu me radhë, pasi edhe në projektligj është dhënë përkufizimi “Organet e qeverisjes qendrore”. Pra, në projektligjin e paraqitur është shtuar: “Janë të gjitha drejtoritë administrative, kompetenca e të cilave shtrihet në të gjithë territorin” dhe kjo ka përjashtuar germën “m” të nenit 2 të direktivës. Pra, direktiva kërkon që 3% të jetë vetëm për godinat e njësisë qendrore, ndërsa për vendoret nuk e kërkon, domethënë, është opsionale, mund të parashikohet ose jo.

Pra, nëse pranohet nga zëvendësministri, duke qenë se është sjellë koncepti në linjë me direktivën, në linjë edhe me parashikimet dhe me çfarë konsiderohen organe të qeverisjes qendrore, pra godina të dhëna të qeverisjes qendrore, unë sugjeroj që të jetë 3%, siç e kërkon direktiva, ndërsa për godinat e tjera të lihet 2%, siç e ka projektligji.

**Gjergj Simaku** - Personalisht, jam dakord. Do të bëjmë ndryshimet përkatëse.

Ju falënderoj!

**Senida Mesi** - Zoti Kasneci dhe zoti Simaku u dakordësuan për ndryshimin si më poshtë vijon: “Duke filluar nga data 01.09.2021, sektori publik siguron se 3% e totalit të stokut të ndërtesave publike në nivel qendror, minimalisht 2%...”

**Dedë Kasneci**- Zonja kryetare, ju lutem!

“3% e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore”. Pjesa tjetër është opsionale, mund të mos parashikohet fare, sepse nuk e kërkon direktiva, por qeveria mund ta parashikojë 2%. Kjo është e rëndësishme për qëllim të përafrimit, zonja kryetare.

**Senida Mesi** - Atëherë, po e lexoj përsëri përkufizimin: “Duke filluar nga data 01.09.2021, sektori publik siguron se 3% e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike të qeverisjes qendrore, minimalisht 2% e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike, të rinovohet çdo vit për të përmbushur kërkesat minimale për performancën e energjisë”. Zoti Simaku, a jeni dakord?

**Gjergj Simaku** - Po, dakord.

**Senida Mesi-** Megjithatë, edhe me sekretariatën, edhe me stafin tuaj do të keni një shkëmbim me email, në mënyrë që të jemi të saktë në definimin, me qëllim që kur të bëhet relacioni dhe përcjellja e këtij relacioni te komisioni përgjegjës të jemi korrektë.

Më vjen mirë që u sqaruam dhe u dakordësuam.

Dua t'ua kaloj fjalën kolegëve deputetë, nëse kanë pyetje, përgjigje, diskutime dhe komente lidhur me projektligjin aktual. Nuk ka pyetje.

Nga Shërbimi Juridik i Kuvendit kam 3 sugjerime rekomandime apo observacione. Bëhet fjalë për nenin 9/4 “Roli model i ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore”, ku kemi një specifikim për metrat katrorë, apo të detyrimit të institucioneve publike, si dhe ato që duhet të japin informacion të kërkuar për stokun brenda afatit të përcaktuar në kërkesë. Pse duhet të shprehemi me kaq detaje në lidhje me një çështje të tillë? Nëse nuk gabohe, bëhet fjalë për një sipërfaqe, ku është e përcaktuar në ligj, faqja 7 e projektligjit, ku thuhet: “Ministri, nëpërmjet Agjencisë përgjegjëse për Eficiencën e Energjisë, përcakton e publikon inventarin e ndërtesave me ngrohje dhe/ose ftohje të organeve të qeverisjes qendrore, me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme mbi 250 m<sup>2</sup>. Inventari përfshin....”. I referohem eksperiencës, sugjerimeve dhe rekomandimeve për teknikë legislative që në momentin që kemi një ndryshim të kësaj sipërfaqe, ndryshon më pak, duhet të vijmë edhe një herë ta rishikojmë ligjin. Pse nuk i lihet diçka e tillë ministrit përgjegjës, me urdhër të brendshëm, sikurse do të jetë edhe nëpërmjet Agjencisë përgjegjëse për Eficiencën e Energjisë. A është detyrim të përcaktojmë një sipërfaqe të tillë?

**Gjergj Simaku** - Është detyrim nga direktiva, është *mot a mot* direktiva. Në fakt, direktiva ka filluar me 1 mijë m<sup>2</sup>, ka zbritur në 500 dhe sot është 250m<sup>2</sup>. Edhe nëse e lëmë 250, nuk ka ndonjë problem. Kjo do të thotë se ndërtesat që janë nën 250 m<sup>2</sup>, që nuk ka gjasa të jenë qendrore, duke përjashtuar ndonjë kopsht, sipas konceptit tonë, nuk mund të merren në konsideratë për çështje të eficiencës, sepse nuk ka vlerë tekniko-ekonomike për t'u bërë. Kështu që, unë mendoj ta lëmë 250 m<sup>2</sup>, me qëllim që të kemi një kufi minimal.

Faleminderit!

**Senida Mesi-** Zoti Simaku, ju falënderoj!

Në fakt, edhe me 2 ose 3% do të ishim shumë të lumtur që të fillonim dhe të realizonim një eficiencë të plotë energjie, qofte edhe për 1% të godinave në nivel qendror apo lokal, për të vazhduar deri në vitin 2030 për të shkuar 5%, 6% ose sa të kemi mundësi.

Lidhur me eficiencën apo me punën e Agjencisë së Eficiencës së Energjisë, në relacion nuk kemi diçka të detajuar lidhur me veprimtarinë e fondit në këta 6 vjet. Prandaj, për mua është e rëndësishme të flasim edhe për çfarë bëhet fjalë në lidhje me fondin e eficiencës së

energjisë. Kemi një fond, i cili përcakton në ligj që mund të japë grante, kredi, garanci financiare dhe/ose lloje të tjera financimi që garantojnë rezultate konkrete. Nëse sot nuk keni informacion, do të donim të na nisni një informacion me shkrim në lidhje me të gjithë veprimtarinë e Agjencisë dhe konkretisht të Eficiencës së Energjisë.

**Gjergj Simaku**- Lidhur me veprimtarinë e Agjencisë, kjo është një çështje që mund ta bëjmë më shpejt, ndërsa lidhur me faktin që kemi hequr fondin nga projektligji i ri, kjo ka të bëjë me faktin që fondi nuk është krijuar kurrë. Pra, ishte një fond, të cilin do ta krijonte qeveria me kredidhënie apo me fonde të papërdorura në buxhetin e shtetit apo me donacione të kësaj natyre. Kjo gjë nuk ka ndodhur dhe praktikisht në 5 vjet, megjithëse përpjekjet kanë qenë të jashtëzakonshme, asnjëherë nuk u arrit në konkluzionin që fondi të krijohet.

Po ta vëmë re, në ligj ka dy mënyra qasjeje lidhur me donatorët dhe ju jeni të njohur me çështjen e donatorëve. Donatorët, para se të japin një sasi të caktuar bëjnë një marrëveshje me objektiv krejtësisht të përcaktuar. Pra, kur vijnë të bëjnë eficiencën, ato e kanë parasysh, për shembull, çfarë është KfW, që ka bërë me Qytetin Studenti dhe e detyrojnë qeverinë që do të financojë qytetin studentit, ose e ka objektiv të përcaktuar se ku do të financojë. Në këtë kuptim, ne do të thoshim se, nëse ne do të pranohim faktin që këto financime do të shkonin në fond, fondi do të bënte aprovime sipas projekteve përkatëse, kemi forcuar qeverisjes e fondit, ose drejtimin e fondeve, me objektivin që të kursejmë. Pra, kur vjen një fond për eficiencën e energjisë, së pari, objekti përkatës, sipas ligjit të ri, auditohet, pasi auditohet, del një raport, del targeti ose objektivi i kursimit dhe vetëm në këtë mënyrë ai lejohet të financohet. Kjo është mjaft e qartë edhe në konceptin tonë.

Kështu që, fondi nuk ka mundur të lëvizë dhe ne nuk kemi pasur ndonjëherë shansin ta bëjmë këtë. Në Shqipëri FSHZH-ja është konkurrenti i fondit për eficiencën e energjisë dhe, praktikisht, çështjen e ndërtimit ai e kryen ndoshta më mirë se sa do ta kryenim ne. Në çdo rast ky ligj parashikon që çdo donacion, çdo ndërtim që bëhet apo çdo rinovim duhet të kalojë përmes auditimit, raportit të auditimit, një raporti të qartë për objektivin që do të arrijë dhe më fund me monitorimin e arritjes së këtij objektivi. Kështu që, unë besoj se nuk ka kuptim të vendosim fondin, sepse edhe direktiva e lë evazive çështjen e fondit të eficiencës. Pra, thjesht ne duhet të ...

**Senida Mesi**- Zoti Simaku, nuk jeni në linjë. Mund të fikni kamerën, në mënyrë që t'ju dëgjojmë.

Deri sa të lidhemi me zotin Simaku dhe nëse nuk ka pyetje ose diskutime me atë që po diskutojmë, dua t'ju të përgëzoj për synimet. Sigurisht, ne duhet të monitorojmë çfarë kemi realizuar dhe, nëse bëhet fjalë për të përcaktuar disa objektiva të godinave ekzistuese, e kemi

shumë të thjeshtë që në prokurimet publike, në ndërtimet apo rikonstrukcionet që bën qeverisja qendrore apo lokale në të vëmë disa kritere, me qëllim që të avancojmë më tutje me pjesën e eficiencës së energjisë. Ndërkohë, nuk e di nëse Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës po bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të krijuar incentiva fiskale në lidhje me ndërtimet private, të cilat kanë në fokus eficiencën e energjisë, apo të ashtuquajtura *green construction*.

Vendet e BE-së kanë incentivat konkrete fiskale, ku një ndërtesë, e cila vjen e certifikuar nga autoriteti përkatës, nga auditorët e energjisë sigurisht, ka një çmim të ndryshëm apo pagesa të ndryshme në lidhje me pagesat në nivel qendror apo me pagesat në nivelin e qeverisjes lokale, nëse ndërtesa është certifikuar si një ndërtesë e gjelbër.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin?

Ju lutem, hapini kamerat ose shpreheni votën tuaj me zë!

Zoti Kamami dakord. Zonja Spahiu dakord.

Zoti Pendavinji?

**Ilir Pendavinji** – Dakord.

**Senida Mesi** – Zoti Velaj? Dakord.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë në votimin e projektligjit nen për nen, me ndryshimet e propozuara dhe të dakordësuara nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit.

Ju lutem, sekretaria e komisionit të mbajë shënim ndryshimin që sapo u dakordësua për 3%-in e detyrimit në nivel qendror të ndërtesave për rikonstrukcion në favor të eficiencës së energjisë dhe 2% në nivel total, pra pushtetit qendror dhe pushtetit lokal.

Kush është dakord? Zoti Kamami, zoti Pendavinji, zonja Spahiu?

**Ilir Pendavinji** – Dakord.

**Arben Kamami** – Dakord, zonja kryetare. Ndoshta nuk e shikoni, por dakord jam.

**Senida Mesi** – Zoti Kamami, nuk ju kemi me kamerë.

Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji dhe e bëjmë gati për t'ia dorëzuar raportin komisionit përgjegjës.

Të nderuar kolegë, a keni ndonjë pyetje, apo diskutim tjetër?

Zoti Simaku dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës mund të largohen.

Zoti Gjoni, fjala për ju.

**Ralf Gjoni** – Kam vetëm një koment që ta dëgjojnë dhe zoti Simaku dhe përfaqësuesit ministrisë. Meqenëse Kryeministria është pajisur me një eficiencë hidrotermike, dua të bëj kërkesën që të mos lihej mënjane edhe Kuvendi, sidomos kryesia e Kuvendit, ku punohet në kushte, sikur jemi në Siberi, pa pikë ngrohjeje. Kështu, meqenëse kalojmë direktiva kaq të mrekullueshme të Bashkimit Europian, do të donim ta ndienim nga afër edhe këtë eficiencën energjetike të ofruar nga direktiva europiane në zyrat e Kuvendit, ku punohet, dhe ju, zoti Kasneci, e dini shumë mirë se në çfarë kushtesh punohet.

Faleminderit!

**Senida Mesi** – Zoti Gjoni, në fakt, jam me mëngë të shkurtra dhe nuk më duket vetja në Siberi. Dua të them, nëse energjia që prodhohet është efiçente apo mund ta kursejmë më shumë, kjo është një çështje në një diskutim tjetër.

Faleminderit dhe mirupafshim!

Mbledhja mbyllet.

## **MBYLLET MBLEDHJA**